LAJME / KRONIKA E ZEZË

Arrestohet një person në Prizren, i dyshuar për shitje dhe posedim të substancave narkotike

Foto ilustruese

15 orë

Policia e Kosovës ka njoftuar se ka arrestuar një person në Prizren, për shitje dhe posedim të substancave narkotike.

Rasti ka ndodhur ditën e enjte, rreth orës 15:00, transmeton Telegrafi.

"Njësiti i DHTN nga burimet informative kanë pranuar një informatë për shitje të narkotikëve nga i dyshuari mashkull kosovar. Me urdhër verbal të prokurorit dhe pëlqimit të gjyqtarit të procedurës paraprake është bërë kontrolli i banesës së të dyshuarit", thuhet në njoftimin e Policisë.

Gjithashtu, Policia ka treguar se cfarë ka gjetur gjatë kontrollit tek personi i dyshuar.

"Gjatë kontrollit janë gjetur dhe konfiskuar: 113.46 gr marihuanë e cila ishte e ndarë në qese plastike, një pako me rizlla, dy mulli për bluarje, një peshore digjitale, një fishek i cal, të pa njohur dhe një telefon", bëhet e ditur në njoftim.

I dyshuari është arrestuar dhe me vendim të prokurorit dërgohet në mbajtje. ***/Telegrafi/***

Policia e Kosovës | Prizren | Substanca narkotike

PETROL

Del në shitje magazina e produkteve të naftës me vendodhje në Kosovë
Sponzorizuar
Lexo më shumë

Programi Dimagra, si t'i humbisni kilogramët e tepërt për 10 ditë
Sponzorizuar
Lexo më shumë

Lajme | Telegrafi
Më të lexuarat në Lajme


Një tjetër vrasje në Vlorë

Hoxhaj: Urime Jugosllavia e re Albin!

Analistët komentojnë ftesën e Kurtit për opozitën lidhur me dialogun dhe refuzimin e Hoxhajt

Haradinaj: Deklaratat e Kurtit për kriminelët e luftës, akt tradhtie

CORONAVIRUS
më shumë

Krejt çfarë dihet rreth "pasaportës për COVID-19 të BE-së"

Vazhdojnë patrullimet e policisë

Bie numri i pacientëve, mbyllet klinika COVID-19 në Mjekësinë Sportive në QKUK

Një viktimë dhe 35 raste të reja me Covid-19 në Shqipëri

TELEGRAFI sh.p.k.
Rr. Rexhep Mala, Aktash, Nr.34, Prishtinë, Kosovë
info@telegrafi.com 038 224 093 - +383 48 222 355

Ky portal mirëmbahet nga kompania "Telegrafi". Materialet dhe informacionet në këtë portal nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër për qëllime përfitimi, pa miratimin e drejtuesve të "Telegrafit". Për ta shfrytëzuar materialin e këtij portali obligoheni t'i pranoni Kushtet e përdorimit.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara © 2006-2021 Portali Telegrafi